

## FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 13 TETOR 2022

Të nderuar kolegë, që keni qëndruar deri në fund të seancës, shumë faleminderit për durimin!

Anglezi Kipling, i përkthyer nga Noli, do ta fillonte kështu atë poezinë e famshme “Në mundsh”, që Noli e ka sjellë në toskërisht: “Në mundsh të mbash në kokë terezinë, ku shokët çmendin dhe fajtorë të nxijnë...” dhe vazhdon me vargje të tjera. Unë e kuptoj që detyra e kolegëve të opozitës është pikërisht që të nxijnë dhe ta bëjnë qeverinë fajtores për gjithçka që ndodh sot në Shqipëri, por që t’i lexosh keq raportet, nuk shkon dhe që të vrasësh të vërtetën, të duhet shumë punë, sepse e vërteta ka një karakteristikë, ajo ngjallet, sado ta vrasësh.

Unë kam përpara dy raporte shumë të rëndësishme, që kanë dalë këtë javë. Shefja e misionit të FMN-së pas takimit me ministren e Financave dhe me Guvernatorin e Bankës Qendrore dha edhe një prononcim për mediet: “Ndonëse ndikimet e drejtpërdrejta të Shqipërisë nga lufta e Rusisë në Ukrainë janë të kufizuara, sfidat, si pasojë e rritjes ndërkombëtare të çmimeve të ushqimit dhe energjisë, kushtet financiare globale më të shtrënguara, që ka gjasë të vazhdojnë, si dhe ngadalësimi i rritjes ekonomike në Europë, krijojnë ato vështirësi që kemi përpara”. Pra, FMN-ja tregon qartë se sfidat ekonomike, që ka përballë sot çdo familje shqiptare, vijnë nga lufta, vijnë nga ngadalësimi i ekonomisë globale e kështu me radhë.

Ndërkohë, po FMN-ja thotë: “Parashikojmë që rritja ekonomike e Shqipërisë për vitin 2022 të jetë 3,7%, mbështetur nga një aktivitet i lartë në turizëm”. Ne sot e filluam seancën me një interpelancë për turizmin. Pra, FMN-ja thotë se ka aktivitet të lartë në turizëm, te pasuritë e paluajtshme dhe te shërbimet. Pra, ekonomia shqiptare po rritet, sepse kjo qeverisje po bën një punë të mirë me turizmin, po bën një punë të mirë me ekonominë, po bën një punë të mirë në mbrojtjen e shtresave vulnerabël, po ashtu edhe me mbajtjen ndezur të motorit ekonomik. FMN-ja përsëri thotë se me rritjen ekonomike të vitit të kaluar qeveria me të drejtë ka nisur konsolidimin fiskal. Këtë nuk e themi ne, por FMN-ja.

Megjithatë, edhe kur e thonë ndërkombëtarët, shokët tanë duan ta nxijnë gjendjen dhe të mbyllin veshët. “Ne mbështesim buxhetin e rishikuar të korrikut”, thotë FMN-ja. Pra, të gjitha ndërhyrjet që ka bërë qeveria janë positive, sipas autoritetit global monetar. Kalojmë te raporti që profesori me të drejtë tha se duhej të ishte diskutuar sot, me të cilin bie shumë dakord, sepse është një nga raportet më të rëndësishme, pra progresraporti, për të cilin zëvendëskryeministrja dha një shpjegim gjerë e gjatë. Unë dua të ndalem përsëri tek ekonomia. Komisioni Europian thotë që Shqipëria ka bërë progres të mire, përparim të mirë dhe është e përgatitur për të zhvilluar më tej një ekonomi të tregut të lirë.

Impakti i pandemisë në ekonomi, deficitin buxhetor dhe borxhi publik ishin më të ulët se i prisnim. Sekretare e Sekretariatit për Procedurat, Votimin dhe Etikën Klotilda Bushka Drejtori i Shërbimit të Redaktorëve Krenar Hajdëri Pra, Komisioni Europian, që shikon të gjithë progresin e vendeve që anëtarësohen, thotë se zhvillimet në ekonominë shqiptare janë shumë më pozitive se priteshin. Për ta mbyllur, unë dua t’ju them se gjërat e mira nuk mund të fshihen, e njëjta gjë ishte ajo që ndodhi dje në Këshillin e Europës. Dallimi midis nesh dhe jush është shumë i qartë: ne bëjmë, ju flisni.

Ne dje kemi mbështetur anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Europës. Unë nuk e kuptoj: a është vëmendja që merr Kosova, që ju gjithmonë dilni dhe e nxini, apo është për shkak se ju keni votuar raportin e Dick Marty-t? Ju faleminderit!